

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
**УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО**  
**UNIVERSITY OF TETOVA**



Zyrës së doktoratave të Universitetit të Tetovës  
Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit juridik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit juridik i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 23.02.2023, sollti Vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional të dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull **“Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA”**, të kandidatit Mr. sc. Joseph Przybyla.

Në bazë të vendimit nr. 13-93/1, të datës 23.02.2023, Komisioni në përbërje: Prof. Dr. Drita Mahmuti-Fazlija (kryetare), Prof. Dr. Faton Shabani (anëtar), Prof. Dr. Shefik Shehu(anëtar), Prof. Dr. Bekim Maksuti (anëtar) dhe Prof. Dr. Fehari Ramadani (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik i paraqet këtë

**R A P O R T**  
**për vlerësimin e disertacionit të doktoratës**

**Të dhënat biografike të kandidatit:**

Mr. sc. Joseph Przybyla është lindur më 17 janar 1979, në Illinois të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku ka kryer shkollimin fillorë dhe të mesëm, si dhe ciklin e parë dhe të dytë të studimeve të magjistraturës.

Studimet themelore i ka përfunduar në janar të vitit 2001, dhe fitoi titullin Bachelor i Arteve, drejtimi: Drejtësia Penale në Universitetin e Lewis-it, në Romeoville në Illinois të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pas kryerjes së studimeve themelore, kandidati Joseph Edward Przybyla në gusht të vitit 2002 mbaron studimet e magjistraturës, dhe fiton titullin Magjistër i shkencave, drejtimi: Drejtësi Penal në Universitetin e Lewis-it, në Romeoville në Illinois të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në dhjetor të vitit 2005, në Universitetin e Northwestern-it në Evanston në Illinois të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, merr Certifikatën e Menaxhmentit, drejtimi: Shkolla e personelit dhe komandës së policisë.

Në dhjetor të vitit 2011, në Universitetin North Central University, San Diego, California të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, merr titullin Magjistër i Biznesit dhe Administratës, Specializim, drejtimi: Siguria Kombëtare.

Në vitin akademik 2015/16 regjistron studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Juridik, me temë "Diplomacy in the Southern Balkans and the impact of the perception of Donald Trump by Balkan born citizens living in the United States" (Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA) të miratuar me datë 28.03.2019, me numër 13-530/2, nga Këshilli Mësimore Shkencor i Fakultetit Juridik, nën udhëheqjen e Prof. dr. Fehari Ramadanit, mentor i kandidatit.

Deri më tani, Mr. sc. Joseph Edward Przybyla ka botuar dy punimet shkencore në revista ndërkombëtare shkencore. Punimi i parë, u botua në revistën International Journal of Advances Research (IJAR). "Diplomacy in the Southern Balkans and the impact of the perception of Donald Trump by Balkan born citizens living in the United States". ISSN NO. 2320-5407. Published: June 2018. Punimi i dytë, u botua në revistën International Education & Research Journal (IERJ). "OHRID FRAMEWORK AGREEMENT FROM INCEPTION TO NOW". E-ISSN No: 2454-9916. Volume:4. Issue:8. Published: Agust 2018.

**Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:**



Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidati Joseph Edward Przybyla i ka kryer me sukses provimet e doktoratës. Që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë e deri më sot kandidati ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të temës. Ai me sukses ka realizuar tre konferencat doktorate, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa artikuj shkencor.

**Analizë e punimit: “Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA”**

Në disertacionin e tij të doktoratës me titull “**Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA**”, kandidati është përpjekur të trajtoj faktorët të cilët kanë ndikuar në politikën e Presidentit amerikan ndaj rajonit të Ballkanit dhe se si kjo politikë është perceptuar nga “ballkanas” që jetonin në Shtetet e Bashkuara gjatë mandatit të Trump, por që kanë lindur në Ballkan. Nëpërmjet këtij studimi, kandidati është përpjekur të kuptoj mendimet e pjesëmarrësve mbi këto çështje dhe çdo faktor tjetër që ata mund të artikulojnë në lidhje me Donald Trump-in dhe administratën e tij.

**Kapitulli i parë** ofron si kornizën teorike për studimin, ashtu edhe një përmbledhje të plotë të literaturës. Kjo përfshin historinë e grupeve të ndryshme ballkanike që u vendosën në Çikago, një diskutim pse Çikago u zgjodh si vendi i studimit kërkimor që diskutojnë informacionin përkatës mbështetës të nevojshëm për të përfunduar këtë analizë.

**Kapitulli i dytë**, ofron një sfond historik të nevojshëm për të kuptuar thjerrëzën përmes së cilës pjesëmarrësit e sondazhit e shohin z. Trump dhe administratën e tij. Në veçanti, ky kapitull do të sigurojë një përmbledhje të marrëdhënieve diplomatike me secilin nga vendet e Ballkanit të përfshira në këtë studim dhe Shtetet e Bashkuara. Ky kapitull gjithashtu ofron një biografi të Donald dhe Melania Trump, si dhe një kronologji të ngjarjeve që ndodhën gjatë zgjedhjeve sikurse kohën midis inaugurimit të Trump-it dhe fillimit të këtij studimi.

**Kapitulli i tretë**, ofron një shpjegim të bazës së hulumtimit në këtë studim. Një shpjegim i problemit të hulumtimit, pyetjes së hulumtimit dhe metodologjisë së hulumtimit është dhënë në këtë kapitull. Kopjet e formularit të miratimit të hulumtimit dhe studimit demografik janë dhënë



në këtë kapitull. Më në fund, një shpjegim i ndikimit të çështjes së shtetësisë adresohet në përfundim të këtij kapitulli.

**Kapitulli i katërt,** siguron rezultatet e studimit kërkimor. Duke qenë se ky është një studim i metodave të përziera, si rezultatet sasiore ashtu edhe ato cilësore diskutohen në këtë kapitull. Duke adresuar anën cilësore të kërkimit, një diskutim i gjerë i intervistave në fokus-grupe është përfshirë në këtë kapitull. Një analizë e pyetjeve sasiore të moshës, gjinisë, kombësisë, sasisë së kohës që jeton në Shtetet e Bashkuara, perceptimi i Donald Trump-it dhe ndjenja se si Ballkani do të kalojë nën Trump-in janë përfshirë gjithashtu në këtë kapitull.

**Kapitulli i pestë,** ofron një analizë të rezultateve të paraqitura në kapitullin katër. Gjithashtu i përfshirë në këtë kapitull është një diskutim i Samitit G-20 dhe Iniciativa e Tre Deteve dhe efekti i tyre në këtë studim. Këto dy ngjarje kanë ndodhur gjatë kohës së mbledhjes së të dhënave të hulumtimit dhe duket se kanë një efekt në bisedat në intervistat në fokus-grupe.

**Kapitulli i gjashtë,** jep përfundimin dhe propozimet për kërkime të mëtejshme. Kjo përfshin kufizimet e këtij studimi dhe fushat në të cilat nuk ishte në gjendje të përqendrohej. Diskuton gjithashtu ide për kërkime të mëtejshme.

**Kapitulli i shtatë,** ofron referencat e përdorura në krijimin e këtij punimi. Konkretisht, është përfshirë një bibliografi e plotë në formatin APA.

**Kapitulli i tetë,** ofron shtojcat e referuara në këtë punim. Kjo përfshinë:  
Fjalimin e z. Trump për Iniciativën e Tre Deteve,  
Anketën e miratimit Rasmussen e Donald Trump,  
Rezolutën 1199 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara,  
Rezolutën 1203 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

#### **Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:**

Gjatë hartimit të këtij punimi doktrate, me titull “**Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA**” kandidati i është përmbajtur respektimit të standardeve metodologjike në punën kërkimore-shkencore.

Në këtë studim kandidati përmes hulumtimeve cilësore në teren është përpjekur të kuptoj perceptimin e politikave të Donald Trump-it dhe administratës së tij duke studiuar imigrantë ballkanikë në metropolin e Çikagos. Ai ka mbledhur informacione nga një larmi individësh dhe



cilësimesh, duke përdorur teknika të shumta të mbledhjes së të dhënave për të kontrolluar rezultatet e tij. Kandidati ka përdorur intervista të thelluara, një sondazh të shkurtër dhe një intervistë në fokus grupe (dhënë secilit prej pesë grupeve të ndryshme) në përpjekje për të kuptuar ndjenjat e tyre. Intervista në fokus grup është zhvilluar me përfaqësues të personave nga kombësi të ndryshme. Ai ka siguruar të dhëna, të cilat i ka shfrytëzuar për studimin e tij; fillimisht ka përdorur teknikat e marrjes së mostrave dhe rekrutimin e pjesëmarrësve. Pastaj ai përshkruan burimet e të dhënave, përfshirë strategjitë e vëzhgimit të pjesëmarrësve dhe të dhënat sasiore. Në fund ka analizuar të dhënat që ka siguruar gjatë hulumtimit. Kërkimi cilësor është veçanërisht i përshtatshëm për të kuptuar kuptimet që pjesëmarrësit u kushtojnë ngjarjeve, veprimeve, situatave, përvojave dhe konteksteve në të cilat ndodhin.

Kërkimi cilësor është gjithashtu një metodë e hulumtimit që është e pajisur mirë për t'u marrë me kapjen e proceseve me të cilat ndodhin situata dhe ngjarje në vend që të përpiqet të arrijë një sërë rezultatesh. Një model i hulumtimit cilësor lejon fleksibilitet të tillë që studiuesit të mund të zbulojnë dhe eksplorojnë marrëdhënie të reja siç ndodhin në procesin e kërkimit. Me këtë strategji induktive, të hapur, ai ka gjeneruar gjetje që janë, "të kuptueshme dhe të besueshme nga përvoja, si për njerëzit që po studiohen ashtu edhe për të tjerët".

Strategjia e tij e marrjes së mostrave nuk ka pasur për qëllim marrjen e një shembulli të rastësishëm, dhe as përgjithësimi nuk ka qenë qëllimi i këtij studimi. Në vend të kësaj, ai ka përzgjedhur informatorët kryesorë përgjatë kategorive të brezave që nga emigracioni, gjinia dhe familja, komuniteti dhe udhëheqja fetare në mënyrë që të arrija kuptimin maksimal të komunitetit ballkanik në Amerikë, veçanërisht në kontekstin lokal dhe cilësor të metropolit të Çikagos. Kështu, ky disertacion përfshin një nëngrup jo-përfaqësues të Ballkanit që banon në Metro Chicago. Sondazhi i shkurtër është krijuar për të mbledhur informacionin bazë demografik (gjinia, origjina kombëtare dhe koha që banon në Shtetet e Bashkuara).

### **Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:**

Tema e doktoratës "**Roli i organizatave ndërkombëtare në menaxhimin e krizës dhe ndërtimin e paqes në Kosovë (1998-1999)**", përbën një përpjekje nga ana e kandidatit për të perceptimin e politikave të Trump-it ndaj Ballkanit Jugor, nga ballkanasit e lindur në SHBA.

Me punën e tij, kandidati është përpjekur të analizoj politikën e Presidentit Trump ndaj vendeve të tjera në përgjithësi dhe atyre të Ballkanit Jugor në veçanti, duke u bazuar në parimin e shpallur “*America First*”, e cila sipas kandidatit ishte më shumë sesa një parullë për Trump - ajo kap instinktet e tij më themelore për çështjet ndërkombëtare

#### **Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:**

Tema të cilën e ka punuar kandidati i takon periudhës së afërt prandaj, nuk është trajtuar gjerësisht nga studiuesit deri tani. Ky studim do të shërbej si nxitje në të ardhmen që kjo temë të hulumtohet më gjerësisht nga studiues të tjerë.

Kandidati ka shfrytëzuar burime relevante, të cilat e bëjnë temën të rezistueshme nga kritikrat shkencore. Ai ka bërë krahasim të burimeve të ndryshme, të cilave u është qasur në mënyrë shkencore.

E veçanta e kësaj teme qëndron në faktin se kandidati ka arritur të realizoj intervista me disa nga personat që përfaqësojnë kombësitë e ndryshme ballkanike në metropolin e Çikagos.

#### **Hulumtime të mundshme në të ardhmen:**

Tema e doktoratës “**Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA**” është e gjerë dhe brenda saj janë trajtuar çështje të ndryshme, çka jep mundësi që në të ardhmen kandidati ose studiues të tjerë të trajtojnë çështje të veçanta.






Kandidati ka bërë përpjekje për të dhënë pasqyrë sa më të plotë të ngjarjeve, të cilat lidhen me temën. Puna e tij përbën kontribut të çmueshëm jo vetëm për fushën raportet e SHBA-ve me vendet e Ballkanit Jugor, por edhe më gjerë. Prandaj, tema e tij mund të shërbej si pikënisje për thellimin e hulumtimeve për politikën e SHBA-ve ndaj vendeve të Gadishullit Ballkanik.



**Vlerësim dhe rekomandim:**

Nisur nga vlerësimet e mësipërme Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “**Diplomacia në Ballkanin Jugor dhe ndikimi i perceptimit të Donald Trump-it nga qytetarët e lindur në Ballkan që jetojnë në SHBA**”, të kandidatit Mr. sc. Joseph Przybyla, ka nderin që t’i propozoj Këshillimit mësimor-shkencor të Fakultetit juridik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

**Komisioni:**

1. Prof. Dr. Drita Mahmuti-Fazlija (kryetare),  ;
2. Prof. Dr. Faton Shabani (anëtar),  ;
3. Prof. Dr. Shefik Shehu (anëtar),  ;
4. Prof. Dr. Bekim Maksuti (anëtar),  ;
5. Prof. Dr. Fehari Ramadani (mentor),  ;

Tetovë,

6 mars 2023